



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Departamenti i Arsimit të Lartë dhe Shkencës

Departamenti i Arsimit të lartë dhe Shkencës, Këshilli Shkencor i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, në mbështetje të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore Shkencore dt. 28 mars 2013 (Gazeta zyrtare nr. 11/02 maj 2013) dhe Udhëzimit administrativ nr. 27/2016, dt. 22.11.2016 për mbështetjen financiare për aplikim të fondeve nga MASHTI për botime dhe publikime shkencore, shpall:

KONKURS

(Për financimin e botimeve dhe publikimeve shkencore për vitin 2024)

Fushat shkencore prioritare për aplikim

Financohen botime ose përkthime nga fushat prioritare shkencore të parapara në Programin Kombëtar të Shkencës:

1. Burimet natyrore, energjia dhe mjedisi
2. Prodhimi bujqësor
3. Studimet mjekësore

4. Studimet ekonomike dhe sociale
5. Studimet gjuhësore, kulturore dhe historike
6. Hulumtime ndërdisiplinare për teknologjitë e komunikimit dhe informacionit.

Kriteret dhe procedurat për botim:

- Të drejtë aplikimi kanë autorët me shtetësi kosovare me vepra shkencore (monografi shkencore), përmbledhje punimesh shkencore (që i bashkon një temë - libra tematikë shkencorë) dhe me përkthime të veprave shkencore të autorëve kosovarë dhe të huaj (gjuhë e huaj - shqip/serbisht dhe shqip/serbisht - gjuhë e huaj), kurse institucionet shkencore të Republikës së Kosovës mund të konkurrojnë me revista shkencore të cilat botohen dhe përmbushin standarde të njohura ndërkombëtare.
- Me përkthime të veprave shkencore, mund të konkurrojnë edhe autorë që janë jashtë vendit, nëse veprat e tyre shkencore me përmbajtjen e tyre, i referohen në mënyrë të qartë Republikës së Kosovës. Në një rast të tillë, aplikimin duhet ta dorëzojë njëri nga autorët a recensentët që punojnë në Republikën e Kosovës.
- Do të merren në konsideratë për botim vetëm libra ose punime që janë të gatshme për botim.
- Një autor ka të drejtë të aplikojë vetëm me një libër apo punim.
- Institucionet shkencore mund të aplikojnë me vetëm një numër reviste duke iu përmbajtur kritereve dhe procedurave për përkthim në gjuhë të huaja.
- Mbështeten botimet ose përkthimet që shquhen për cilësi të lartë shkencore dhe që botimi/përkthimi i tyre nuk do të ishte i mundur pa mbështetje financiare. Merren në konsideratë për botim përkthimet e monografive shkencore dhe publikimeve tjera konform Udhëzimit administrativ (MASHTI) nr. 27 /2016 për mbështetjen financiare për aplikim të fondeve nga MASHTI për botime dhe publikime shkencore.

Përkthimet

- Mbështeten përkthime në një gjuhë të huaj me reputacion ndërkombëtar.
- Përkthimi duhet të bëhet nga një njohës me eksperiencë të gjuhës përkatëse dhe kjo të konfirmohet me dëshmi përkatëse duke ofruar bibliografitë e përkthyesve.
- Financohen përkthimet që shquhen për cilësi të lartë shkencore që kanë relevancë në promovimin e vlerave historike, gjuhësore, kulturore dhe shkencore të Kosovës.
- Pajtimin e shtëpisë botuese të vendit ku botohet punimi shkencor si dhe definimin e të drejtës së autorit.
- Cilësia shkencore e punimit garantohej së paku nga **tri recensionet**.

Kush mund të aplikojë ?

- Aplikimet për botime të veçanta bëhen vetëm prej personit fizik.
- Merren parasysh botimet e individëve dhe institucioneve që e ushtrojnë veprimtarinë shkencore në Republikën e Kosovës.
- Aplikimi bëhet vetëm prej autorit (redaktorit).

Aplikacionet për botim duhet të kenë këto dokumente:

- **Letërnjoftimi i aplikuesit (kopja)**
- **Aplikacioni i plotësuar me të dhënat në detaje të aplikuesit apo institucionit**
- **Tri recensionet të punimit (dy vendore dhe një ndërkombëtare)**
- **Pajtimin e shtëpisë botuese si dhe definimin e të drejtës së autorit**
- **Deklaratë e noterizuar nga autori që libri/punimi nuk është i botuar pjesërisht apo tërësisht më herët**
- **Dy kopje të dorëshkrimit të përfunduar dhe të gatshëm për botim, (dorëshkrimet e pa përfunduara nuk do të shqyrtohen)**
- **Një kopje e versionit final në formë elektronike (USB), si dhe**
- **Kërkesat tjera në bazë të UA për botime dhe publikime.**

Konkursi mbetet i hapur nga **dt.23.04.2024-10.05.2024**

Aplikacioni me dokumentacion të kompletuar dorëzohet në arkivin e MASHTI-it, zyra nr. 4, ndërsa të gjitha informatat rreth aplikimit merren në zyrën nr. 302/b, kati 3 te z. Fidan Kozhani.

Dokumentacioni i pakompletuar dhe aplikimi me vonesë nuk shqyrtohen.

Detajet e Kontaktit;

Emri: Fidan Kozhani

Posta elektronike :

e-mail: fidan.kozhani@rks-gov.net ,Adresa postare :

Rr. Agim Ramadani p. n 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel.+381(0) 38 200 20123

Për informata më të detajuara dhe kushtet specifike mund te njoftoheni duke e shkarkuar

Udhëzimin administrativ me nr: 27/2016, në vegëzën e web: <http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/12/rotated-1.pdf>.